



KUVENDI I KOMUNËS

Numër protokolli:

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja a) dhe paragrafi 12.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 të datës 04. Qershor 2008"), Kuvendi i Komunës së Pejës, në mbledhjen e mbajtur më datë Maj 2026, miraton :

DRAFT - S T A T U T I
Nr. 01/2026
I KOMUNËS SË PEJËS

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1
Statuti

1. Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Me këtë statut përcaktohet organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e Komunës së Pejës.
3. Statuti është bazë për sigurimin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësive të Komunës ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera në fuqi.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Statuti rregullon kompetencat e Komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe mënyrën e vendosjes për punët publike, bashkëpunimin ndërkomunal e ndërkombëtar, organet e Komunës dhe administratën komunale, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit Komunal, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.

Neni 3
Përkufizimet

Termet vijues kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

-**“Kartë”**- do të thotë Karta evropiane mbi vetëqeverisjen lokale, e miratuar nga Këshilli i Evropës më 15 tetor 1985. -**“Komunitet”** -do të thotë grup komuniteti që i përket një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor. -**“Qeveria”**- do të thotë Qeveria e Republikës së Kosovës.;

-**“Qytetar”** -ka kuptimin e paraqitur në [nenin 10 të Ligjit aktual mbi Shtetësinë];

-**“Vetëqeverisje lokale”**- do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale, të themeluara sipas këtij Ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore.

-**“Komunë”**- do të thotë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar të përcaktuar me ligj, siç parashihet në Ligjin mbi numrin, emrat dhe kufijtë administrativë të komunave.

-**“Kuvendi i Komunës”**- është organi më i lartë i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur. -**“Kryetari”**- është organi më i lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

-**“Parimi i subsidiaritetit”**- do të thotë që çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase;

- **“Kompetencat vetanake”**- do të thotë kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin.

-**“Kompetencat e deleguara”**- do të thotë kompetencat e qeverisë qendrore dhe të institucioneve të tjera qendrore ekzekutimi i të cilave përkohësisht i caktohet me ligj komunave;

-**“Kompetencat e zgjeruara”**- do të thotë kompetencat që u jepen me ligj një komune, apo një numri komunash;

-**“Rishikimi administrativ”**- është e drejta dhe kompetenca e institucioneve të qeverisë qendrore për ta rishikuar ligjshmërinë e autoriteteve lokale në fushën e kompetencave të zgjeruara dhe ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktiviteteve të tyre në fushën e kompetencave të deleguara.

-**“Organi mbikqyrës”**- do të thotë ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale dhe/ose institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës. në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë;

-**“Mbikëqyrja e ligjshmërisë”**- do të thotë rishikimi i realizuar nga organi mbikqyrës për t’u siguruar se aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe se organi që i ka nxjerrë nuk ka vepruar në tejkalim të mandatit të tij të miratuar ligjor;

-**“Mbikqyrja e përshtatshmërisë”**- do të thotë rishikimi i bërë nga organi mbikqyrës për t’u siguruar se kompetencat e deleguara janë ekzekutuar në përputhje me rregullat, kriteret dhe standardet e përcaktuar nga qeveria qendrore dhe për t’u siguruar se masat e marra nga komuna kanë qenë përkatëse për arritjen e objektivave dhe rezultateve të përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

- **“Votim i shumicës”**- do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votim në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi. Ky është një mekanizëm përmes të cilit duhet të merren vendimet e kuvendit të komunës;

-**“Shumica prej dy të tretave (2/3)”**- do të thotë votimi që kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës..

-**“Ministria”**- është ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale, nëse konteksti qartazi nuk nënkuptohet ndryshe; - **“Statuti i komunës”**- është akti kryesor ligjor që miratohet nga komuna dhe në pajtim me legjislacionin e qeverisë qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të komunës;

-**“Rregullorja e punës”**- është akt që miratohet nga kuvendi i komunës që parashikon rregullat e rendit dhe të mirësjelljes. -**“Rregullore komunale”**- është akt që miratohet nga numri i kërkuar i anëtarëve të kuvendit të komunës që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të tij

Neni 4 Komuna

1. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, ligjet tjera dhe statutin e Komunës.
2. Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të gjitha niveleve.
3. Komunat i zbatojnë politikat dhe praktikat e tyre për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t’i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.
4. Të gjitha autoritetet komunale u përgjigjen qytetarëve të komunës në format e përcaktuara me ligj.

5. Qytetarët e komunës kanë të drejtë që të marrin pjesë në aktivitetet e komunës, siç përshkruhet me ligj.
6. Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të tyre për t'u ofruar më afër shërbime qytetarëve, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të këtij Statuti.

Neni 5

Selia e Komunës është në Pejë, rruga **Aleksandër Moisiu p.n.**

Neni 6

Dita e Çlirimit

Komuna e Pejës shënon Ditën e Çlirimit të saj më 16 Qershor të çdo viti kalendarik .

Neni 7

Simbolet komunale

1. Komuna ka emblemën dhe flamurin. Ato përdoren brenda territorit të saj në pajtim me Ligjin për Simbolet Shtetërore. Simbolet nuk duhet u përngjajnë simboleve të shteteve të tjera, apo simboleve të komunave në Republikën e Kosovës apo jashtë saj.
2. Përmbajtja, përdorimi dhe ndryshimi i emblemës dhe flamurit, do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës në pajtim me Ligjin për Simbole Shtetërore.
3. Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç Komunës, nuk mund ta përdorë emblemën, flamurin dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 8

Vulat

1. Komuna e Pejës dhe organet e saja, kanë vulat e rrumbullakëta dhe ato katrore.
2. Përmasat, përmbajtja e tekstit dhe mënyra e mbajtjes dhe udhëheqjes së vulave, do të përcaktohet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Ligjin për Vula.
3. Përmbajtja e tekstit të vulave është e shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Neni 9

Statusi ligjor i Komunës

1. Komuna e ka statusin e personit juridik. Komuna e ka të drejtën:
 - 1.1. Të padisë dhe të paditet në gjykatë;

- 1.2. Të posedojë dhe të menaxhojë pasurinë dhe të përcaktoj kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të saj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj;
- 1.3. Të jetë pronare dhe bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
- 1.4. Të lidhë kontrata;
- 1.5. Të punësojë stafin, dhe
- 1.6. Të angazhohet në aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj.

Neni 10 Qytetarët e Komunës

Qytetar i komunës është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës që me adresë të regjistruar vendbanimi në Komunën e Pejës.

Neni 11 Barazia në shërbime

Organet e Komunës së Pejës, kujdesen që të gjithë qytetarët e Komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër, me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet. (Neni 4.2 – LVL 03/L-040).

Neni 12 Delegimi i kompetencave tek komunat tjera

1. Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saja në fusha të caktuara tek komunat tjera, apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.
2. Vendimin për delegimin e përgjegjësive në fusha të caktuara dhe për bashkëpunim e propozon Kryetari dhe miraton Kuvendi i Komunës.

KAPITULLI II Lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet

Neni 13 Territori

1. Territori dhe kufijtë e Komunës janë të përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.

2. Territori i Komunës së Pejës si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve sipas zonave kadastrale si në vijim:

1. Babiq,
2. Baran,
3. Bellopojë,
4. Bllagajë,
5. Bogë,
6. Brestovik,
7. Brezhanik,
8. Broliq,
9. Buçan,
10. Çallapek,
11. Bregu i Zi,
12. Qyshkë,
13. Doberdol,
14. Drelaj,
15. Dubove,
16. Dugaivë,
17. Gllaviçicë,
18. Glllogjan,
19. Gorozhdevc,
20. Graboc,
21. Haxhaj,
22. Jabllanicë,
23. Joshanicë,
24. Kliçinë,
25. Kosuriq,
26. Koshutan,
27. Kotradiq,
28. Kërstoc,
29. Kryshec,
30. Kuqisht,
31. Llabjan,
32. Lipë,
33. Leshan,
34. Lubeniq,
35. Lutogllavë,
36. Logjë,
37. Llozhanë,
38. Jabllanicë e Madhe,
39. Shtupeq i Vogël,
40. Vitomiricë,
41. Vragoc,
42. Vranoc,
43. Zagërm,

44. Zahaq,
45. Zllapek,
46. Jabllanicë e Vogël,
47. Shupeq i Madhë,
48. Malaj,
49. Nabergjan,
50. Nakëll,
51. Novosellë,
52. Ozdrim,
53. Pejë,
54. Pepiq,
55. Pishtan,
56. Pavlan,
57. Poçestë,
58. Rekë e Allagës,
59. Radac,
60. Rashiq,
61. Raushiq,
62. Ramunë,
63. Rosujë,
64. Ruhot,
65. Sigë,
66. Shkrel,
67. Sverkë,
68. Treboviq,
69. Trestenik,
70. Turjak.

3. Me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës, mund të përcaktohen lagje, vendbanime periferike dhe vendbanime tjera komunale.

4. Me rregullore të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës do të rregullohet struktura organizative dhe funksionale e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane si dhe mënyrën, kohën, numrin dhe çështje tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

Neni 14 **Ndryshimi i kufijve komunal**

Komuna me vendim të Kuvendit mund të inicioj ndryshimin e kufijve të Komunës, dhe procedura bëhet në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave. .

Neni 15 **Marrëdhëniet me lagjet urbane, fshatra dhe vendbanimet**

1. Komuna, me vendim të Kryetarit brenda kompetencave komunale për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra administrative për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës komunale apo dekoncentroj shërbimin me qëllim të ofrimit sa ma afër qytetarëve

2. Zyra komunale apo shërbimi ofrohet nga stafi i komunës dhe është pjesë përbërëse e administratës komunale dhe drejtohet nga personeli i cili zgjidhet nga Komuna në bazë të legjislacionit përkatës. Për ushtrimin e këtyre detyrave fondet e nevojshme sigurohen nga Komuna.

3. Komuna mban kontrollin dhe përgjegjësinë e plotë të secilës fushë të kompetencës së saj të dekoncentruar. .

KAPITULLI III

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komunës

Neni 16

Kompetencat vetanake

1. Komuna i ka kompetencat e plota dhe ekskluzive (të patjetërsueshme në fushat që vijojnë:

1.1. zhvillimin lokal ekonomik;

1.2. planifikimin urban dhe rural;

1.3. shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;

1.4. zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;

1.5. mbrojtjen e mjedisit lokal;

1.6. ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;

1.7. përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;

1.8. ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;

1.9. promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin e barazisë gjinore.

1.10. ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;

1.11. ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenjes sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e qendrave të përkujdesit, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

1.12. banimin publik;

1.13. shëndetësinë publike;

1.14. licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

1.15. emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

- 1.16. ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- 1.17. turizmit;
- 1.18. aktivitetet kulturore, rinore, sportive dhe të lira;
- 1.19. çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër
- 1.20. Çështje të tjera të cilat me ligj ose akte nënligjore janë paraparë si kompetenca vetanake të Komunës.

2. Komuna e Pejës, si plotësim i aktiviteteve të përmendura më sipër, ushtron kompetencat e deleguara nga autoriteti qendror i Republikës së Kosovës në pajtim me ligjet, për kompetencat vijuese:

- 2.1. shënimet kadastrale;
- 2.2. regjistrimin civil;
- 2.3. regjistrimin e votuesve;
- 2.4. regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- 2.5. distribuimin e pagesave të ndihmës sociale;
- 2.6. mbrojtja e pyjeve, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

Neni 17 **Përgjegjësitë tjera shtesë**

1. Komuna e Pejës, do të ushtrojë përgjegjësitë tjera shtesë, përpos atyre të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 13 të këtij Statuti në pajtim me ligjet në fuqi, nëse për këtë janë siguruar buxhetet e nevojshme nga ana e organeve kompetente për të përmbushur objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

2. Shqyrtimin e kompetencave të deleguara e ushtron organi i qeverisë qendrore të Republikës së Kosovës që i ka deleguar ato.

3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në pajtim me kreun e X të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ushtron të gjitha përgjegjësitë e saja në lidhje me mbikëqyrjen e ushtrimit të kompetencave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e Komunës nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme.

KAPITULLI IV

Organet e Komunës

Neni 18 **Organet e Komunës**

Organet komunale janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari/ja i/e Komunës.

Neni 19

Kuvendi i Komunës

1. Kuvendi i Komunës, është organi më i lartë komunal i cili ushtron funksionet dhe kompetencat vendimmarrëse në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.
2. Kuvendin e Komunës e përbëjnë anëtarët e zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët me votim të fshehtë në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.
3. Kuvendi i Komunës i ka 35 anëtarë dhe numri i tyre përcaktohet nga organi kompetent në cdo palë zgjedhje në pajtimin me neni t 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
4. Të gjithë qytetarët e komunës mund të kandidohen në kuvendin e komunës, me kusht që t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
5. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 vjet.
6. Anëtarit të Kuvendit të Komunës i pushon cilësia e anëtarit në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 20

Humbja e mandatit të anëtarit/es së Kuvendit të Komunës

Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar/e:

- 20.1 me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- 20.2 nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- 20.3 nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- 20.4 nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhër për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- 20.5 nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye; nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të papërgjegjshëm.

Neni 21

Funksionet e Kuvendit

Kuvendi i Komunës së Pejës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale, Statutit të Komunës dhe akteve tjera në fuqi

Neni 22

Aktet e punës së Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës e miraton dhe ndryshon Statutin e Komunës siç parashihet me dispozitat e nenit 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Çdo miratim apo ndryshim i Statutit të Komunës duhet të aprovohet së paku me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

2. Kuvendi i Komunës e miraton Rregulloren e Punës dhe mund ta ndryshoj atë, nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së Punës, aprovohet më shumicë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 23

Delegimi i kompetencave të Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e veta për marrjen e vendimeve lidhur me:

1.1. statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret dhe aktet tjera komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;

1.2. miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;

1.3. miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;

1.4. shqyrtimin e planit vjetor të punës dhe raportit vjetor;

1.5. themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij LVL-së dhe këtij Statuti;

1.6. emërimin dhe shkarkimin e nënkryetarit për komunitete;

1.7. zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Kuvendit Komunës;

1.8. nivelin e tarifave dhe ngarkesave;

1.9. krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;

1.10. emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

1.11. arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;

1.12. marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe

1.13. përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

2. Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës përvec përgjegjesive në nenin 19.1 mund t'ia delegojë përgjegjësi tjera Kryetarit/res të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin e këtyre përgjegjësive në çdo kohë sipas procedurës së njëjtë.

Neni 24

Kompetencat e Kuvendit

1. Kuvendi i Komunës në kuadër të kompetencave të tij miraton këto akte:

1.1 Statutin e Komunës;

1.2 Rregulloren e Punës;

1.3 Rregulloret komunale dhe

1.4 Çdo akt tjetër të nevojshëm për funksionimin efikas të Komunës.

2. Aktet tjera dhe vendimet e Kuvendit të Komunës përveç Statutit dhe Rregullores për punën e Kuvendit miratohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë me kusht që në momentin e votimit është siguruar kuorumi, nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me ligj.

3 Komuna ndanë dekorata, tituj nderi, mirënjohje dhe shpërblime për individ dhe personave juridikë, në përshtatje me kontributet dhe vlerat, rolin dhe ndikimin e tyre në opinionin publik. Kushtet dhe mënyra e ndarjes së tyre përcaktohet me rregullore të veçantë. .

4. Kuvendi i Komunës me propozimin e Kryetarit të Komunës për merita të veçanta mund të shpall qytetarë/re nderi të Komunës së Pejës personalitete të ndryshme nga vendi dhe jashtë vendit.

Neni 25

Mbledhja e parë, betimi dhe deklarata solemne

1. Kuvendi i Komunës duhet ta mbajë mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, thirret nga Kryetari/rja i/e Komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

3. Nëse Kryetari nuk e thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës brenda afatit prej 15 ditësh, atëherë, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda 15 ditëve nga dita kur kryetari i zgjedhur ka dështuar që ta thërret mbledhjen inauguruese.

4. Nëse anëtari/rja, më i/e vjetër i/e Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij/saj në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës të cilat mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit/ses të/së Kuvendit të Komunës, kryesohet nga anëtari/ja më i/e moshuar i/e Kuvendit të Komunës që është i pranishëm në mbledhje dhe mund të kenë në rend të ditës vetëm dhënien e betimit dhe zgjedhjen e Kryesuesit.

Neni 26

Verifikimi i mandatit

Mandati i çdo anëtari/re të Kuvendit të Komunës, verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar/e e Kuvendit..

Neni 27

Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës

1. Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:
“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t’i ushroj autorizimet e mia si këshilltar/re i/e Kuvendit të Komunës së Pejës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.
2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, të cilët/at nuk e nënshkruajnë betimin solemn ose mandatin në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, brenda një (1) muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë dhe zëvendësohen sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Neni 28

Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës e zgjedh Kryesuesin/sën e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve, me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.
2. Votimi në të gjitha zgjedhjet për Kryesues/se të Kuvendit të Komunës është me vota të fshehta. Për t’u zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar si Kryesues i Kuvendit, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
3. Në rast se në votimin e parë asnjëri/ra prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet Kryesues/se i/e Kuvendit të Komunës.
4. Nëse edhe pas votimit të dytë, asnjëri/ra nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e kërkuar të votave si në paragrafin 3 të këtij neni, shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryesues/sja i/e Kuvendit të Komunës, zgjidhet kandidati/ja, i/e cili/la merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë , ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr.2009/01 “Për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës”.
6. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjidhet Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e Kryesuesit/ës të/së Kuvendit të Komunës përsëritet.

Neni 29

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit

1. Kuvendi i Komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për kryesuesin/sen e Kuvendit, i cili përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë të Kuvendit të Komunës.
2. Komisioni është përgjegjës që të numërojë votat dhe t’i komunikojë rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 30

Nënshkrimi i akteve të Kuvendit të Komunës

26.1 Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës është i obliguar t'i nënshkruaj të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe është i obliguar të kujdeset për procedimin e tyre, dhe një kopje të aktit të nënshkruar ia dorëzon kryetarit/ës të/së Komunës. Afati për nënshkrim nuk duhet të jetë më shumë se 7 ditë.

26.2 Në rast të mungesës së arsyeshme dhe me autorizimin e tij/saj, aktet e Komunës mund të nënshkruhen edhe nga Zëvendës Kryesuesi për Komunitete.

Neni 31

Kuorumi dhe mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve

1. Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të kuvendit apo komiteteve. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi që merr Kuvendi i Komunës.
2. Në të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe komitet e tij çdo anëtarë, duke përfshirë edhe Kryesuesin e mbledhjes, ka nga një votë, por Kryesuesi ka votë shtesë vetëm në rast barazimi të votave për dhe kundër një propozimi.
3. Kuvendi i Komunës dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregullore të punës së Kuvendit të Komunës.
4. Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë statut dhe ligj, vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.
5. Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorunit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 32

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit/së Kuvendit të Komunës mbledhjen e kryeson anëtari/ja më i/e vjetër i/e Kuvendit të Komunës.
2. Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë (10) seanca në vit.
3. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:
 - 3.1. data e mbajtjes së mbledhjes;
 - 3.2. koha e mbajtjes së mbledhjes;

- 3.3. vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- 3.4. rendi i ditës për mbledhje;
- 3.5. materialet e mbledhjes dhe
- 3.6. të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

4. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin për Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.

5. Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Neni 33

Barazia në informim për seancat e Kuvendit të Komunës

Mbledhjet e kuvendit dhe trupave të tij duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e Punës. Kryesuesi i cili i thërret apo i udhëheqë mbledhjet, duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje, të kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe të kenë mundësi të marrin pjesë të barabartë në diskutime dhe votim.

Neni 34

Transparenca e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e kuvendit të Komunës dhe komiteteve të Kuvendit të Komunës, janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara që është objekt diskutimi, përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

2. Në qoftë se Kuvendi i Komunës, gjatë punës së tij vendos që për arsye të caktuara me ligj të përjashtoi publikun në shqyrtimin e ndonjë çështjeje nga seanca e kuvendit, duhet të marrë vendim me shumicë votash të anëtarëve prezent për përjashtimit të publikut.

3. Kuvendi i Komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për Informim, njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- 3.1. shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- 3.2. mediet e shkruara dhe elektronike lokale dhe
- 3.3. faqen e internetit të kuvendit të Komunës dhe rrjetet sociale zyrtare të Komunës

4. Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- 4.1. datën e mbledhjes,
- 4.2. kohën e mbledhjes ,
- 4.3. vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- 4.4. rendin e ditës me material përkatës

5. Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve.

Neni 35

E drejta e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Çdo anëtar/e i/e publikut, i/e cili/a merr pjesë në Kuvendin e Komunës dhe komiteteve të tij, me lejen e Kryesuesit/ës të/së takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes, konform rregullave të përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 36

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo me kërkesë të Kryetarit/res.
2. E drejta për ta thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme, gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
4. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, nuk mbahet nëse nuk janë të njoftuar me shkrim të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku, siç kërkohet me rregulloren e punës së Kuvendit, së paku tre (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.
5. Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
6. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 37

Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

1. Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbali përmban emrat e anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe anëtarëve dhe personave tjerë të ftuar, rendin e ditës, esencën e diskutimeve, rezultatin numerik të votimit, çfarëdo vote që ka dhënë çdo njeri, anëtar dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara.
2. Procesverbalin e mban një shërbyes/se civil/e komunal/le, i/e caktuar nga shërbimet e Kuvendit të Komunës në konsultim me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës. Çdo kush ka të drejtë ta shikoj procesverbalin dhe ta marrë një kopje. Procesverbali mbahet në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe i njëjti duhet të miratohet në takimin e ardhshëm të kuvendit. Procesverbalet duhet të

nënshkruhen nga **Kryesuesi/sja i/e** mbledhjeve dhe nga zyrtari/ja i/e autorizuar për mbajtjen e procesverbalit.

Neni 38

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës

1. Në pajtim me nenin 39 të LVL anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës ka të drejtë:

1.1 Të marrin pjesë plotësisht në punimet e kuvendit. Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe në rregulloren e tij të punës.

1.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari/ja, nga të emëruarit/et e tij/saj, Nënkryetari/ja i/e Komunës për komunitete dhe Kryesuesit/et të kuvendit dhe komiteteve. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen me rregulloren e punës.

1.3 Anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës mund të paraqes vërejtje me shkrim ku do t'i bashkëngjiten procesverbalit;

1.4 Anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të kuvendit të Komunës, anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë Kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit;

1.5 Anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës mund të kërkojë nga Kryetari/ja informacione që janë të nevojshme për punën e tij si anëtar/e nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në Kuvendin e Komunës;

1.6 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, obligohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata/ato janë anëtarë/re, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre;

1.7 Anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës, lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të Kuvendit.

Neni 39

Konflikti i interesave të anëtarëve të Kuvendit

1. Anëtari/rja i/e Kuvendit të Komunës, apo anëtari/ja i/e komitetit dhe i komisionit, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj, ka interes personal ose material.

2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, të komiteteve dhe të komisioneve mund të tërhiqen vullnetarisht ose me vendim të shumicës së atij forumi ose me kërkesë të palës së tretë. Më për së afërmi, kjo çështje do të rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës.

3. Anëtarët e kuvendit të Komunës, nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë në administratën e komunës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 40 Deklarata financiare

Në pajtim me nenin 38.3 të LVL, çdo anëtar/ja i/e Kuvendit të Komunës, para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare dhe obligohen të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin në regjistrin që e mbanë Kryetari/ja i/e Komunës.

Neni 41 Pushimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit

Anëtari/ja i/e kuvendit të Komunës, i/e cili/la nuk nënshkruan betimin - deklaratën solemne brenda një (1) muaji pas zgjedhjes pa arsye pushon të jetë anëtarë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 37.2 të LVL dhe zëvendësohet sipas procedurës në pajtim me ligjin.

KAPITULLI V

Komitetet e përhershme dhe komitetet tjera

Neni 42 Komitetet obligative

1. Kuvendi i Komunës themelon komitete të përhershme si:

- 1.1. Komitetin për Politikë e Financa dhe
- 1.2. Komitetin për Komunitete.

2. Në pajtim me nenin 51.2 të LVL, Kuvendi Komunës formon edhe këto komitete tjera sipas nevojës.

4. Përfaqësimi në komitetet e përhershme duhet të pasqyrojë në mënyrë proporcionale numrin e vendeve që i mbajnë partitë politike apo koalicionet në kuvendin komunal dhe përfaqësimin gjinor.

5. Kryesuesi/ja dhe zëvendës kryesuesi/ja i/e çdo komiteti zgjidhet nga anëtarët e komitetit me përjashtim të Komitetit për politikë e financa, i cili kryesohet nga kryesuesi/ja i/e kuvendit dhe në rast mungese kryesohet nga anëtari/ja më i/e e vjetër e komitetit.

6. Përbërja e komiteteve duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.

Neni 43

Përbërja e Komiteteve

1. Komitetet tjera të nevojshme të parapara me nenin 38 paragrafi 2 të Statutit, do të kenë nga (5) pesë deri në shtatë (7) anëtarë dhe në përbërjen e tyre shumica e anëtarëve të këtyre komiteteve zgjedhën nga anëtarët e kuvendit të Komunës, duke respektuar proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor.
2. Komitetet në radhët e veta mund të kenë anëtar jashtë Kuvendit të Komunës, të cilët duhet të kenë përvojë adekuate dhe kritere profesionale, varësisht nga komiteti ku emërohet. Emërimi i tyre do të bëhet nga Kuvendi i Komunës me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës, pas pajtimit paraprak të subjektit politik përkatës, duke respektuar proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor.

Neni 44

Komitetet tjera

1. Kuvendi i Komunës përpos komiteteve të përhershme sipas nevojës mund të formojë edhe komitete tjera të nevojshme.
2. Kryesuesi/ja zgjidhet nga anëtarët e komitetit përkatës që janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Neni 45

Kompetencat e Komiteteve

1. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të tjera të përhershme, do të rregullohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Kuvendi i Komunës.
2. Kryesuesit/et e komiteteve duhet të pasqyrojnë objektivisht proporcionin e vendeve në kuvendin Komunal përveç komiteteve të përhershme.

Neni 46

Komiteti për Politikë dhe Financa

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit, duhet të zgjedhën nga radha e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përfaqësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike në Kuvendin e Komunës.
3. Përbërja e Komitetit duhet të ketë përfaqësimin gjinor që reflektohet nga propozimet e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend.
4. Anëtarët e Komitetit, nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera

5. Mbledhjet e Komitetit kryesohen nga Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, kryesohet nga anëtari/ja më i/e e vjetër e komitetit.

6. Kryesuesi/ja i/e Komitetit propozon çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në komitet.

Neni 47

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloret, buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari/ja dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 48

Komiteti për Komunitete

1. Komiteti për Komunitete duhet t'i ketë 9 anëtarë.

2. Anëtarët e Komitetit, zgjedhën nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.

3. Komunitetet pakicë në Komunë, duhet të kenë përfaqësimin e paraparë me Ligjin në fuqi në Komitetin për Komunitete.

4. Përbërja e Komitetit duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.

5. Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një (1) përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

6. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Neni 49

Komitetet Konsultative

1. Komitetet konsultative janë trupa ndihmës të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet komunale të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.
2. Kuvendi i Komunës përpos komiteteve si trupa punuese të tij, me vendim të veçantë themelon komitete konsultative në pajtim me ligjet në fuqi.
3. Themelimi i komiteteve konsultative në Komunë, ka për qëllim që qytetarët dhe grupet tjera të interesit, të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes për interes publik.
4. Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete konsultative ad hoc për çështje të caktuara, mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes.
5. Për themelimin e secilit komitet duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Komunës.
6. Anëtarët e Komiteteve konsultative, zgjedhën për mandat 4 vjeçar.
7. Komitetet konsultative në përbërjen e vet kanë (7) shtatë anëtarë dhe reflekton përfaqësim gjinor
8. Për të gjitha çështjet tjera që lidhen me punën e komiteteve konsultative, do të zbatohen dispozitat e udhëzimeve administrative me të cilat rregullohet mënyra e organizimit dhe të funksionimit të komiteteve konsultative në komunë.
9. Komitetet në kuadër të kompetencave të veta lidhur me çështjet e caktuara, mund t'i rekomandojnë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve përkatëse.
10. Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të çështjeve të caktuara nga kompetencat e tija, ia rekomandon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe marrjen e vendimeve përkatës

Neni 50

Transparenca publike e punës së Kuvendit dhe Komiteteve

1. Me qëllim që puna e Kuvendit të Komunës të jetë sa më transparente i tërë dokumentacioni ju ofrohet anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komiteteve para apo gjatë mbledhjes, e që ndërlihen me çështjet e shtruara për mbledhje.
2. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve tjera të tij janë të hapura për publikun. Kuvendi i Komunës, komitetet dhe komisionet tjera, mund të vendosin për përjashtimin e publikut nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e medieive, kur plotësohen njëra prej kushteve në pajtim me nenin 45.3 të LVL. Vendimet për përjashtimin e opinionit merren me shumicë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, komiteteve ose komisioneve tjera.

Neni 51

Informimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës

1. Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit Komunal duhet të adresohen me shkrim tek zyrtari i përgjegjës i Komunës nga i cili kërkohen informatat.
2. Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga **Kryetari/ja i/e** Komunës ose personi tjetër i autorizuar nga ai, i cili duhet ta shënoj datën e kërkesës së marrë dhe datën e përgjigjes së dhënë.

Neni 52 Kufizimi në informata

Informatat të cilat bien në kategorinë e përcaktuar në nenin 45.3 të LVL, në bazë të kushteve të caktuara duhet të mos jenë të hapura. Arsyet për një veprim të tillë duhet t'i jepen anëtarëve dhe duhet të ruhen në regjistër.

KAPITULLI VI Zgjedhja e Kryetarit/es te Komunës

Neni 53 Zgjedhja e Kryetarit/es të Komunës

1. Kryetari/ja i/e Komunës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët që kanë të drejtë vote në Komunë, në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet Komunale në fuqi.
2. Kryetari/ja i/e Komunës zgjidhet për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjin.

Neni 54 Betimi i Kryetarit/es të Komunës

1 .Me rastin e zgjedhjes, Kryetari/ja i/e Komunës e bën betimin apo deklaratën solemne përpara anëtarëve të Kuvendit Komunal. Teksti i betimi është më sa vijon:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Pejës, me nderë, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë”

2. Kryetari/ja që dështon të japë betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve e humb mandatin.

Neni 55 **Përgjegjësitë e Kryetarit/ës**

1. Kryetari/ja i/e Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- 1.1. përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
 - 1.2. udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
 - 1.3. ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
 - 1.4. ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
 - 1.5. emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
 - 1.6. emëron dhe shkarkon *këshilltarët e tij dhe stafin mbështetës* të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
 - 1.7. organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
 - 1.8. propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
 - 1.9. propozon zhvillimin e Komunës, planet rregulluese dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
 - 1.10. raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës dhe
 - 1.11. mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
 - 1.12. do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo-shumicë dhe
 - 1.13. aktivitetet tjera që i caktohen me këtë statut dhe me ligj.
- 1.14 Nxjerr vendim për bashkimin e dy apo më shumë drejtorive komunale, shuarjen e një drejtorie ose themelin e drejtorisë së re sipas paraqitjes së nevojave specifike të paraqitura në komunë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe miratimin e buxhetit.

Neni 56 **Aktet e Kryetarit/ës të Komunës**

Kryetari i Komunës **merr** vendime dhe lëshon urdhëresa brenda fushës dhe kompetencave të tij.

Neni 57 **Përfundimi i mandatit**

1. Mandati i Kryetarit/ës të Komunës përfundon:

- 1.1. me përfundimin e mandatit;
- 1.2. me rastin e vdekjes së tij;
- 1.3. në rast të dorëheqjes së tij;
- 1.4. nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;

- 1.5.nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- 1.6.nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me LVL;
- 1.7.në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon Kryetarin e Komunës nga cilësia juridike dhe
- 1.8.në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 58 **Mungesa e Kryetarit/es të Komunës**

Nëse Kryetari/ja i/e Komunës përkohësisht mungon apo përkohësisht nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e tij/saj, Nënkyetari/ja i/e Komunës me kërkesë të tij ose saj i ushtron funksionet ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të kryetarit/ës të/së Komunës.

Neni 59 **Suspendimi dhe shkarkimi nga detyra e Kryetarit/es të Komunës**

- 1.Kryetari/ja mund të suspendohet dhe shkarkohet sipas procedurave të parapara në nenin 64 të LVL.
- 2.Qytetarët e Komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e Kryetarit/ës të Komunës në pajtim me nenin 72 të LVL.

Neni 60 **Nënkyetari/ja i/e Komunës**

- 1.Në Komunë, Kryetari/ja i/e Komunës e ka një Nënkyetar/e. Nënkyetari/ja emërohet nga Kryetari/ja për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari/ja.
- 2.Me kërkesë të Kryetarit/ës, Nënkyetari/ja i ndihmon Kryetarit/ës në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit/ës në mungesë të tij.
- 3.Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit të komunës atë e zëvendëson nënkryetari, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, sipas legjislacionit përkatës për zgjedhjet
- 4.Kur posti i Nënkyetarit/es mbetet i lirë, Kryetari/ja emëron Nënkyetarin/en e ri/re, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

Neni 61 **Nënkyetari/ja i/e Komunës për Komunitete**

1. Në Komunën e Pejës, ku komuniteti jo shumicë është më pak se 10% e qytetareve, emërimi i Nënkyetarit/ës të/së Komunës për komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë, mund të

bëhet pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës. Nënkyetari/ja për komunitete emërohet për mandat të njëjtë si të Kryetarit/ës.

2. Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit/es për komuniteteve, propozohet nga Kryetari/ja i/e Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

3. Nënkyetari/ja për komunitete do t'i ndihmojë Kryetarit/es dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin/en lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

4. Kur posti i Nënkyetarit/ës për komunitete mbetet i lirë, Kryetari/ja propozon nënkryetarin/en e ri/re, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 62 **Konflikti i interesave**

1. Dispozitat e nenit 59 të LVL, do zbatohen në rast të konfliktit të interesit të Kryetarit/ës të/së Komunës. Menjëherë pas zgjedhjes së tyre, Kryetari/ja i/e Komunës e ndërprejnë çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë së tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

2. Me rregullore të punës së Kuvendit të Komunës, mund të parashihen masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar Kryetarin/en nga procedurat e vendimmarrjes dhe në ato administrative në rast kur ka konflikt interesi.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të nenit 58 të këtij statuti për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohen mutatis mutandis edhe për Nënkyetarin/en e Komunës dhe Nënkyetarin e Komunës për komunitete.

Neni 63 **Kompensimet**

1. Për punën që e bëjnë për Komunën: Kryetari/ja i/e Komunës, Nënkyetarët e Komunës, Kryesuesi/ja dhe zëvendës kryesuesi/ja i/e KK-së, anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët e komiteteve përkatëse, kompensohen në harmoni me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik dhe aktet përcjellëse.

2. Lartësia e kompensimit të anëtarëve të gjitha komiteteve tjera të zgjedhura nga Kuvendi i Komunës së Pejës dhe komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës dhe duhet të jetë ekuivalent me kompensimin që i bëhet komiteteve obligative të Kuvendit të Komunës.

KAPITULLI VII

Adimistrata Komunale

Neni 64

Drejtoritë

1.Administrata komunale organizohet ne drejtori. Secila drejtori komunale udhëhiqet nga drejtori. Drejtoret i emëron dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

2.Komuna e Pejës do ti këtë këto drejtori:

- 2.1 Drejtoria për Administratë,
 - 2.2. Drejtoria për Shëndetësi,
 - 2.3. Drejtoria për Arsimi,
 - 2.4. Drejtoria për Kulturë dhe Bashkëpunim me Jashtë,
 - 2.5. Drejtoria për Rini dhe Sport
 - 2.6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
 - 2.7. Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm
 - 2.8. Drejtoria për Punë Komunale,
 - 2.9. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
 - 2.10. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim,
 - 2.11. Drejtoria për Turizëm
 - 2.12. Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike,
 - 2.13. Drejtoria për Mirëqenje Sociale,
 - 2.14. Drejtoria për Investime Kapitale,
 - 2.15. Drejtoria për Teknologji dhe Digjitalizim,
 - 2.16. Drejtoria për Mjedis dhe Parqe,
 - 2.17. Drejtoria për Inspektive
7. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim vazhdon funksionimin në kuadër të administratës komunale deri në zbatimin e plotë të aranzhimeve teknike për transferimin e kompetencave tek Agjencioni Kombetar i Emergjencave
8. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit/ës të/së Komunës dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
9. Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit/ës për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij/asaj të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
10. Drejtori zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës dhe ligjet e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
11. Drejtori përgatit programin e punës dhe prezanton raportet e periodik të punës për drejtorinë e tij.

12. Drejtori është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshme të punës së drejtorisë.
13. Drejtori përgatit dhe prezanton planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve.
14. Përgjigjet në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me kompetencat lëndore të drejtorisë që udhëheqë.
15. Është përgjegjëse për paraqitjen e projekteve dhe akteve normative të cilat kanë karakter të përgjithshëm nga kompetencat lëndore të organit.
16. Merr pjesë dhe kontribuon në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve dhe në mbledhje me Kryetarit të Komunës.
17. Drejtoret lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i përgjigjen Kryetarit/ës të/së Komunës.
18. Fushëveprimi, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive të Shërbimit Civil Komunal të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, do të caktohen me Vendim të posaçëm konform përgjegjësisë të përcaktuara me ligj dhe organizim të brendshëm komunal.

Neni 65 **Konfliktet e interesit për Drejtorët**

- 1.Çdo Drejtor do të përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjeje për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij/ a të saj, ka ndonjë interes personal ose financiar.
- 2.Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash në një regjistër të cilin e mban drejtoria për administratë dhe personelit.
- 3.Me Rregulloren e punës do të caktohen masat të cilat merren për t'i përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë konflikt interesash.
- 4.Drejtorët e drejtorive nuk kanë të drejtë të jenë udhëheqës të ndonjë kompanie , institucioni privat apo të ndonjë organizate joqeveritare që merret afërsisht me fushat e njëjta të drejtorisë që udhëheqë drejtori i drejtorisë

Neni 66

Zyrat

- 1.Përpos drejtorive komunale, Kuvendi i Komunës themelon edhe këto njësi organizative:

- 1.Kabineti i Kryetarit/ës,
- 2.Njësia administartive e Kuvendit Komunal
- 3.Njësia për çështje juridike
4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

5. Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore
6. Njësia e Auditimit të Brendshëm,
7. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun
8. Njësia e Prokurimit Publik
9. Njësia për Komunitete dhe Kthim
10. Njësia për Integritet Evropian dhe Diasporë.
11. Njësia për Planifikim Strategjik dhe Raportim

2. Detyrat, organizimi dhe përgjegjësitë rregullohen me Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale

KAPITULLI VIII

Financat e Komunës dhe procedurat buxhetore

Neni 67 Buxheti

1. Komuna e Pejës ka buxhetin dhe financat e saja për të ushtruar kompetencat e saja. Buxheti i komunës përbëhet prej të hyrave vetanake, granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës të donacioneve dhe të hyrave tjera ku më për së afërmi rregullohen me Ligjin për Financat Lokale dhe aktet tjera.

2. Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të Komunës, janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës.

3. Kryetari/ja i/e Komunës disa nga përgjegjësitë që kanë të bëjnë me administrimin financiar mund t'i bartë tek Nënkryetari/ja i/e Komunës, dhe te Drejtori i drejtorisë buxhet për financa.

Neni 68

Drejtorët e drejtorive të komunës do ta mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese brenda drejtorisë së tyre, si dhe duhet t'i ofrojnë të gjitha informatat drejtorisë për buxhet dhe financa, e auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm.

Neni 69

Drejtori i Buxhetit dhe Financave, duhet t'i jep këshilla financiare Kryetarit/ës të/së Komunës, Komiteteve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga këto organe të Komunës.

Neni 70

Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të Komunës, janë të përcaktuara Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

Neni 71

Komuna, mbledh të hyra vetanake në përputhje me lligjet në fuqi. Të hyrat përcaktohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës në harmoni me ligjin.

Neni 72 **Raporti vjetor**

1.Kryetari/ja i/e Komunës në konsultim me Kryesuesin, duhet të sigurohet që raporti vjetor t'i paraqitet Kuvendit të Komunës ashtu siç kërkohet me ligj.

Neni 73

1.Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

2.Buxheti duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal, dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe të përditshme të Komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

3.Organet komunale kompetente, me akt të veçantë janë të obliguara të përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e furnizimit që i plotësojnë kriteret e parapara me ligj.

Neni 74 **Miratimi i buxhetit**

1. Kryetari i Komunës, është përgjegjës për propozimin e buxhetit, për formulimin dhe hulumtimin e drejtimit strategjik të Komunës në të ardhmen.

2.Viti fiskal i komunës fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të vitit përkatës. Kryetari/ja i/e Komunës ia dorëzon Kuvendit të Komunës propozim buxhetin komunal për vitin e ardhshëm fiskal për miratim më së voni deri me datë 1 shtator të vitit.

3.Kuvendi i Komunës, shqyrton dhe miraton buxhetin e Komunës, për vitin e ardhshëm fiskal, më së largu deri me 30 Shtator.

Neni 75 **Buxheti i ndërmarrjeve publike lokale**

1.Ndërmarrjet publike lokale të cilat kryejnë shërbime publike lokale i dorëzojnë Kuvendit të Komunës buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së

propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri me 1 dhjetor para vitit të ardhshëm fiskal.

2. Në rast se një ndërmarrje afron shërbime publike lokale, për më shumë se një komunë, komuna bënë marrëveshje me komunat gjegjëse për lartësinë e tarifave dhe mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarive të asaj ndërmarrje në pajtim me procedurat dhe rregullat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 76

Auditimi i brendshëm

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi në pajtim me dispozitat e Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Neni 77

Pasuria e Komunës

1. Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Komuna ka të drejtë të shes dhe të jap me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.
3. Komuna mbanë dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim.
4. Kryetari/ja i/e komunës emëron komisione (ad hoc) me qëllim të regjistrimit të pasurisë së tundshme dhe të paluajtshme të komunës më së voni një (1) muaj para përfundimit të vitit fiskal.

KAPITULLI IX

Marrëdhëniet ndërkomunale dhe partneritetet

Neni 78

Bashkëpunimi ndërkomunal, ndërkufitar dhe ndërkomunal-ndërkombëtar i komunave

1. Kryetari/ja i/e Komunës pas konsultimeve me Kryesuesin, duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin e Komunës, për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
2. Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.
3. Kryetari/ja e Komunës , duhet t'i prezantoj rekomandimet e tij tek Kuvendi i Komunës, në lidhje me marrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale, për mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike që ofrohen më shumë se një komunë.

4. Komuna mund që brenda kornizës së ligjit, të bëjë marrëveshje që të bashkëpunojë dhe të formojë partneritete me kuvendet tjera komunale, ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

5. Komuna mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

6. Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet komunës së Pejës dhe komunave kufitare, mund të bëhet vetëm në pajtim me ligjin. 7. Komuna ka të drejtë për marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal-ndërkombetar duke respektuar kërkesat e Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal.

KAPITULLI X

Shërbimi Civil Komunal

Neni 79

1. Shërbimi Civil i Komunës udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik. Shërbimi Civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti i Komunës, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

1.1. Kryetarit/ës, Nënkryetarit/ve dhe Drejtorëve të komunës;

1.2. Kryesuesit/ja, zëvendës Kryesuesit/ja dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

1.4 Stafit të emëruar në Kabinetin e Kryetarit sipas legjislacionit në fuqi

2. drejtorët e komunës, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e Komunës dhe nëpunësit civilë të administratës së komunës, nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

2. Zgjedhjet për Kuvendin e Komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civil. Me rastin e zgjedhjes, shërbyesit civil vendosin për njëren nga përgjegjësitë që vendosin të mbajnë mbrenda afatit të përcaktuar me ligj.

Neni 80

Udhëheqësi i Personelit dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Në kuadër të administratës komunale themelohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e cila udhëhiqet nga Udhëheqësi i Personelit.

2. Procedurat për zgjedhjen, rekrutimin dhe largimin e tij i udhëheq Kryetari i Komunës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik.

Neni 81

Punësimi në Shërbimin Publik Komunal përveç rasteve të rregulluara ndryshe me ligj mbikëqyret dhe rregullohet nga Udhëheqësi/ja i Personelit, për të siguruar që Shërbimi Publik Komunal reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik. Shërbimi Civil Komunal si tërësi, duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 82

Udhëheqësi i Personelit i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës, në cilësinë e tij/saj si Udhëhehëqësi më i lartë administrativ (ZKA), si dhe e këshillon atë për çështje strategjike dhe të politikave të burimeve njerëzore.

Neni 83

Udhëhehëqësi i Personelit është përgjegjës për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha funksioneve të menaxhimit të burimeve njerëzore në komunë dhe vepron si autoritet profesional në këtë fushë.

Neni 84

Të gjithë Shërbyesit Publik, i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë në pajtim me ligjin, i zbatojnë dhe i përfillin urdhrat e eprorëve të tyre, përveç rasteve kur detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me të drejtat e komuniteteve.

Neni 85

1.Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Komunë rregullohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

KAPITULLI XI

Konsultimet dhe pjesëmarrja e publikut

Neni 86

Konsultimet me publikun

1.Organet përgjegjëse të komunës duhet të sigurojnë zbatimin e procesit të konsultimit publik, gjatë hartimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës për të cilat konsultimi publik është i obligueshëm në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Administratë të hapur në Komuna.

2.Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin; ligjshmërisë, transparencës, barazisë, mosdiskriminimit dhe efikasitetit në procesin e konsultimit publik.

Neni 87

1.Komuna mund të shfrytëzoj secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (si dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):

- 1.1.fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
- 1.2.kontaktet me grupet e interesit, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;

1.3. anketat për zbatimin e politikës duke përfshirë informimin e klientëve dhe qytetarëve që kanë interesa.

1.4. shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje dhe prezantim;

1.5. takimet publike;

1.6. dëgjimet publike;

1.7. studimet për vlerësim të efekteve të implementimit të vendimeve komunale, studime që duhet të bëhen nga komisionet profesionale të caktuara nga kuvendi komunal dhe për fushat e rëndësishme të qeverisjes komunale.

Neni 88

Kryesuesi/sja i/e Kuvendit të Komunës dhe Kryetari/ja i/e Komunës, kanë autoritet të mbajnë konsulta publike, për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.

Neni 89

Njoftimi për konsultimin publik duhet të bëhet së paku 14 ditë kalendarike përpara datës së mbajtjes dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

Neni 90

1. Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues, duhet të përfshijë një përmbledhje të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre, do të jetë më e lehtë për lexuesit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.

2. Kur përcaktohen grupet e interesit në procesin e konsultimit, Komuna duhet të sigurojë që palët relevante të kenë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

Neni 91

Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t'i adoptojë format komunikuese në mënyrë që t'i përmbushë synimet e audiencës, pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit. Konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare dhe mediat sociale të komunës.

Neni 92

Komuna duhet të ketë kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet që në afat prej 30 ditëve nga dita e mbajtjes së konsultimit me publikun është e obliguar që përmes zyrës së Kryetarit të Komunës t'u jap përgjigje kërkesave me shkrim të qytetarëve.

Neni 93

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura, në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të komunës dhe në mjetet tjera të komunikimit publik.

Neni 94

Takimet me publikun

1. Takimet me publikun duhet të mbahen në hapësira që janë të mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtë mujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.
2. Përveç takimeve të parapara me nenin 91.1 të këtij Statuti, takimet tjera me publikun mund të mbahen për çështje tjera që janë me interes publik, sa herë që organet e Komunës e sheh të arsyeshme.

Neni 95

1. Kryetari/ja i/e Komunës apo përfaqësuesit e tij/saj, duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin, ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes.
2. Në takimet publike janë të obliguar të marrin pjesë zyrtaret më të lartë të organeve të Komunës si: Kryetari/rja i/e Komunës, Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës, drejtorët e drejtorive, kryesuesit/et e komiteteve dhe zyrtarët kompetentë për çështje të diskutimit publik.
3. Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta, apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

Neni 96

Nëse bëhet një pyetje në takim publik, e që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

Neni 97

Për çdo takim publik mbahet procesverbali i cili duhet të ruhet me të gjitha informatat e hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga pjesëmarrësit e takimit publik dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

Neni 98

Kërkesat dhe iniciativat e qytetarëve të evidentuara në procesverbalin e mbledhjes publike, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës, obligohen t'i shqyrtojnë brenda afatit prej 60 ditëve pas mbajtjes së mbledhjes dhe t'i njoftojë parashtruesit e kërkesave lidhur me vendimin e aprovuar.

Neni 99

Format tjera të konsultimit, pjesëmarrja publike dhe referendumi

- 1.Për çështjet e rëndësisë së veçantë, komuna organizon referendum.
- 2.Organizimi i referendumit bëhet në përputhje me ligjin përkatës.

Neni 100

Peticionet

- 1.Secili person fizik dhe juridik apo organizatë që ka interes në komunë, ka të drejtë t'i paraqes petition Kuvendit të Komunës, për cilëndo çështje që lidhet me punën e Komunës. Peticioni është kërkesë për Kuvendin, për t'u marrë me çështjet specifike apo për të miratuar rregullore dhe vendime të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.
- 2.Kuvendi i Komunës duhet të njohë rëndësinë e petitionit dhe t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të përfshira në petition. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik, në të cilin qytetarët diskutojnë për çështjet me interes së bashku me zyrtarët komunal.
- 3.Të gjitha petitionet mund t'i drejtohen Kuvendit të Komunës, Kryetarit/res të/së Komunës, Kryesuesit/ses të/së Kuvendit, apo drejtorive komunale, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet postës elektronike ose të shkruar.

Neni 101

- 1.Kuvendi i Komunës nuk do të ketë parasysh asnjë petition që ka të bëjë me çështje që nuk janë kompetencë dhe përgjegjësi e Komunës dhe organeve të saja.
- 2.Çdo petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit/ëve dhe emrat, numrin e letërnojftimit dhe adresat e personave që e nënshkruan. Lënda e petitionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të petitioni/ankesës.

Neni 102

- 1.Kryesuesi/sja i/e Kuvendit në bashkëveprim me Kryetarin/ren i/e Komunës, do ta paraqes çdo petition para Kuvendit të Komunës brenda afatit prej gjashtë (6) javësh nga dita që ai/ajo e pranon petitionin, gjegjësisht në takimin e ardhshëm të radhës së Kuvendit të Komunës nëse në afatin e caktuar nuk është shqyrtuar i njëjti.
- 2.Kuvendi i Komunës mund t'ia referoj petitionin komitetit përkatës të Kuvendit për shqyrtim të mëtejshëm. Organizatori(ët) i/e petitionit do të ketë të drejtë t'i drejtohet pjesëmarrësve të çdo mbledhjeje ku shqyrtohet petitioni.

Neni 103

- 1.Kuvendi i Komunës do të marrë një vendim përfundimtar lidhur me lenden e petitionit më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë pasi të bëhet prezantimi i petitionit në Kuvendin e Komunës.
- 2.Vendimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim organizatorit/ëve të petitionit.

Neni 104

Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar projekt rregullore, brenda kompetencave të Komunës, për miratim nga Kuvendi i Komunës apo me votë e qytetarëve në pajtim me ligjin.

Neni 105

Organizatat jofitimprurëse

Komuna e Pejës e përkrahë aktivitetin e organizatave jofitimprurëse, aktiviteti i të cilave është në kuadër të ofrimit të shërbimeve në kuadër të përgjegjësisve të përgjithshme të Komunës. Të gjitha këto organizata i përmbahen ligjit në fuqi kur ofrojnë shërbime dhe kur zhvillojnë aktivitete.

KAPITULLI XII

Informimi, komunikimi dhe qasja ne dokumentet zyrtare

Neni 106

Organet komunale obligohen që t'i informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre, duke komunikuar drejtpërsëdrejti në gjuhën e tyre dhe duke ju lejuar qasje në dokumente zyrtare në pajtim me ligjet përkatëse dhe aktet nënligjore.

Neni 107

Kuvendi i Komunës miraton rregullore, që në mënyrë më të detajuar rregullon përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj, siç përcaktohet me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Neni 108

Ankesat e qytetarëve

- 1.Çdo qytetarë mund të parashtrojë ankesë në afatin ligjor ndaj vendimit administrativ të organeve të komunës, nëse ai apo ajo mendon se i janë cenuar të drejtat e tij ose saj.
- 2.Shqyrtimi i ankesave do të bëhet në pajtim me ligjin për procedurën përgjithshme administrative dhe me ligje te veçanta.

KAPITULLI XIII

Dispozitat përfundimtare

Neni 109

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, dispozitat që përcaktojnë riorganizimin e drejtorive komunale zbatohen në mënyrë të plotë vetëm pas nxjerrjes dhe miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punëve të Administratës Komunale, me të cilën përcaktohen saktësisht fushëveprimi, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimi i brendshëm i secilës drejtori dhe njësi organizative.
2. Deri në miratimin e Rregullores së paraparë në paragrafin paraparak, drejtoritë ekzistuese vazhdojnë të ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre sipas organizimit dhe akteve në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
3. Zbatimi i strukturës së re organizative dhe funksionalizimi i drejtorive të reja kushtëzohet me miratimin e buxhetit të Komunës dhe me rishikimin dhe harmonizimin e linjave buxhetore në përputhje me strukturën e re organizative.

Neni 110

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kataster vazhdon ofrimin e shërbimeve të saj deri në transferimin e kompetencave tek Agjencia Katastrale e Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 111

Me aprovimin e këtij Statuti të gjitha aktet tjera të Komunës do të harmonizohen brenda gjashtë (6) muajve me Statutin në fuqi me përjashtim të buxhetit që ndryshimet do të reflektohen në buxhetin fiskal 2027.

Neni 112

Procedurat për ndryshim dhe plotësimin e Statutit të Komunës

1. Iniciativa për hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund të ndërmerret nga:

- 1.1. Kryetari/ja i/e Komunës;
- 1.2. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës;
- 1.3. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe
- 1.4. 15% e qytetarëve të Komunës me të drejtë vote.

2. Propozimi për ndryshimin e Statutit të Komunës duhet t'i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës para shqyrtimit final, duhet ta konsultoj publikun në lidhje me atë propozim, ku afati për konsultim me publikun nuk mund të jetë më i shkurt se 14 ditë dhe as më i gjatë se 30 ditë.

3. Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës sipas nenit 18 paragrafi 1 të këtij Statuti.

4.Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i Komunës, duhet të vendosë se a do ta miratoj Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të gjitha vërejtjeve të marra.

5.Kuvendi i Komunës me rastin e marrjes së vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës dhe akteve tjera në kompetencë të Kuvendit të Komunës, emëron një komision të përhershëm, i cili do të jetë i balancuar në aspektin profesional, politik, etnik dhe gjinor.

Neni 113

Në rast kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat e ligjit do të mbizotërojnë.

Neni 114

Statuti i miratuar para hyrjes në fuqi i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe **Rregullore (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave**

Neni 115

1. Ky Statut hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i Komunës së Pejës 01.Numër 01-016/01-413431, i datës 30. Korrik 2020.

KRYESUESI I KUVENDIT